

UDHËZIM
Nr.39, datë 8.12.2009

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.21, DATË 30.7.2009 “PËR
PROCEDURAT E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT
TË DOKTORATËS, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 47, pika 1 dhe 2, dhe 50 pika 4 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimit të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor””, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr.21, datë 30.7.2009 “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë” të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 9 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

“9. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga Këshilli i Profesorëve të njësisë kryesore të institucioneve të arsimit të lartë, përgjegjëse për organizimin e programit përkatës të doktoratës, mbi bazën e propozimit të departamenteve përkatëse. Kandidatët nga personeli akademik, të punësuar me kohë të plotë në institucionet e arsimit të lartë, kanë përparësi.”.

2. Pika 10 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

“10. Për shqyrtimin e propozimeve të ardhura nga departamentet, dekanati, në bashkëpunim me Këshillin e Profesorëve të njësisë kryesore përgjegjëse për programin e doktoratës, ngre komisione *ad-hoc*, sipas departamenteve, të përbëra nga anëtarë të brendshëm dhe të jashtëm të personelit akademik të drejtimit të studimit në fjalë, që kanë së paku gradën shkencore “doktor”. Kryetari i çdo komisioni është përgjegjësi i departamentit. Në rastet kur përgjegjësi i departamentit nuk ka titullin “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”, kryetari i komisionit është një anëtar i Këshillit të Profesorëve dhe përgjegjësi i departamentit është anëtar i komisionit *ad-hoc*”.

3. Pika 11 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

“11. Një javë pas mbylljes së aplikimeve, komisionet *ad-hoc* paraqesin listat e kandidatëve fitues në Këshillin e Profesorëve të njësisë kryesore. Lista e kandidatëve fitues shpallet nga dekani jo më vonë se 2 javë nga mbyllja e aplikimeve.”.

4. Pika 12 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

“12. Dekani i njësisë kryesore përcakton afatet e ankimimit të kandidatëve të shpallur jo fitues. Dekanati shqyrton çdo aplikim dhe shprehet me vendim. Vendimi i tij është përfundimtar.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj